



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 mars 2020
Nr. ref.:RK 1540/20

VENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS

në

rastin nr. KI100/19

Parashtrues

Bedri Gashi si përfaqësues i pretenduar i
Q. B., F. G., T. M., Z. B. dhe B. B.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së akteve të paspecifikuara
të autoritetit publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bedri Gashi, avokat nga Prishtina, i cili pretendon që i përfaqëson Q. B., F. G., T. M., Z. B. dhe B. B. nga Klina (në tekstin e mëtejshëm: përfaqësuesi i pretenduar).

Vendimi i kontestuar

2. Përfaqësuesi i pretenduar konteston 1. Veprimet e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë; 2. Veprimet e Komunës së Klinës dhe procedurat që zhvillohen në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Klinë, rrjedhimisht jo ndonjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike.
4. Përfaqësuesi i pretenduar nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) pretendon se i janë cenuar përmes ndonjë akti të një autoriteti publik.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] e rregullin 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 qershor 2019, nëpërmjet postës përfaqësuesi i pretenduar e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 17 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
8. Më 11 korrik 2019, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të pretenduar, ku e njoftoi për regjistrimin e kërkesës dhe nga ai kërkoi të sjellë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë, që të specifikojë saktësisht se cilat të drejta u janë shkelur dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin e kontestojnë.
9. Më 19 korrik 2019, përfaqësuesi i pretenduar dorëzoi në Gjykatë autorizimin e përgjithshëm të 26 gushtit 2016. Gjithashtu u paraqitën disa komente shtesë në lidhje me rastin, që në thelb ishin të ngjashme me kërkesën e dorëzuar me 11 qershor 2019.
10. Më 4 dhjetor 2019, Gjykata përsëriti kërkesën për dokumente shtesë me njoftimin se në rast të mosjelljes së autorizimit për përfaqësim para Gjykatës, kërkesa do të refuzohet në procedurë të shkurtër në bazë të paragrafit 5 të

rregullit 35 të Rregullores së punës. Përfaqësuesi i pretenduar nuk dorëzoi sqarimet e kërkuara.

11. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

12. Çështja e parashtruar e personave të cilët pretendon se i përfaqëson avokati Bedri Gashi, ka të bëjë me bllokimin e rrugës së lagjes në Komunën e Klinës nga ana e fqinjët të tyre S. H. Ky kontest mes të fqinjëve nën pretendimin e falsifikimit të hartave të paluajtshmërisë, është paraqitur nga ana e përfaqësuesit të pretenduar në: (i) Komunën e Klinës [përmes peticionit të paraqitur në Komunën e Klinës për *'lirimin e pronës së uzurpuar'* më 22 gusht 2016]; tek (ii) Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë A. K. [përmes kallëzimit penal të 13 korrikut 2015, kundër S. H. dhe disa zyrtarëve të Komunës së Klinës] dhe në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Klinë [përmes padisë C. nr. 361/14 për kontest civil, e cila ende nuk është vendosur].
13. Gjykata nuk i referohet më tej fakteve të këtij rasti, pasi që kërkesa është parashtruar nga një përfaqësues i pretenduar, i cili nuk ka dëshmuar të ketë autorizim për të parashtruar këtë kërkesë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Përfaqësuesi i pretenduar i kërkesës nuk ka kontestuar ndonjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik dhe nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë cenuar përmes ndonjë akti të një autoriteti publik.
15. Përfaqësuesi i pretenduar i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar një *"vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, ndonjë vërejtje, këshillë, mendim, rekomandim, ide etj, lidhur me rrugën e uzurpuar të të dëmtuarve, pse nuk e kryen detyrën: 1. A. K., prokuror në Prokurorinë Themelore Pejë-tani kryeprokuror, 2. Komuna e Klinës dhe 3. Gjykata në Klinë"*.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 21 [Përfaqësimi] të Ligjit, i cili parashikon:

“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala”.

19. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili specifikon:

“[...]

(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor; [...].

(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm”.

20. Gjykata rikujton që kërkesa është dorëzuar nga Bedri Gashi i cili pretendon të jetë i autorizuar për të përfaqësuar Q. B., F. G., T. M., Z. B. dhe B. B., nga Klina. Gjykata vëren se përfaqësuesi i pretenduar nuk ka bashkëngjitur në shkresat e lëndës një autorizim të vlefshëm për Gjykatën.
21. Gjykata gjithashtu rikujton se kishte kërkuar dy herë nga përfaqësuesi i pretenduar që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin përkatës të vlefshëm, por ai nuk iu ishte përgjigjur kërkesave të Gjykatës të përmendura me anë të shkresave të 11 korrikut dhe 4 dhjetorit 2019.
22. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, Gjykata vëren se përfaqësuesi i pretenduar: (i) nuk e ka sjellë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë; (ii) nuk ka specifikuar e as qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri kushtetuese i janë shkelur; dhe (iii) nuk ka kontestuar asnjë akt të ndonjë autoriteti publik.
23. Mosdorëzimi i autorizimit të vlefshëm në Gjykatë i pamundëson Gjykatës shqyrtimin e një kërkesë në pajtim me nenin 21 të Ligjit dhe rregullin 32 të Rregullores së punës.
24. Në këtë aspekt, Gjykata konkludon se kërkesa është e paplotë dhe nuk është e qartësuar sepse përfaqësuesi i pretenduar nuk kishte dorëzuar në Gjykatë autorizimin e vlefshëm për përfaqësimin e palëve të cilët ai pretendon se i përfaqëson para Gjykatës (shih rastet e Gjykatës nr. KI23/18, parashtrues, *Ismet Kërçagu*, si përfaqësues i pretenduar i A. K., M. K., B. K., F. K. dhe A. K., Vendim për refuzim të kërkesës, i 7 shkurtit 2019; nr. KI16/18, parashtrues, *Sahit Musa*, si përfaqësues i pretenduar i K. N., Vendim për refuzim të kërkesës i 31 dhjetorit 2018; nr. KI30/18, parashtrues, *Sahit Musa*, si përfaqësues i pretenduar i N. H.,

XH. H. dhe S. H., Vendim për refuzim të kërkesës, i 10 majit 2018 dhe rastin KI203/18, parashtues, *Afrim Salihu* si përfaqësues i pretenduar i L. K., Vendim për refuzim të kërkesës i 26 qershorit 2019).

25. Gjykata thekson se është e domosdoshme që përfaqësuesit të dëshmojnë se ata kanë marrë udhëzime specifike dhe të qarta për përfaqësim të viktimës së pretenduar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës (shih rastin, *Angelique Post kundër Holandës*, kërkesa nr. 21727/08 GJEDNJ, Vendimi i 20 janarit 2009).
26. Në dritën e këtyre fakteve, Gjykata më tej i referohet edhe rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“[...] (5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze. [...]”.

27. Gjykata konsideron se përfaqësuesi i pretenduar nuk ka ofruar informata dhe nuk ka dorëzuar dokumente siç i ishte kërkuar nga Gjykata.
28. Rrjedhimisht, Gjykata bazuar në rregullin 35 (5) të Rregullores së punës konstaton se kërkesa e përfaqësuesit të pretenduar duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 22.4 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi